



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PEQIN
NJËSIA E PROKURIMIT

Peqin, më 17/5/2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Riparime dhe mirëmbajtje makinash”;

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

50112000-3

50114000-7

VLERA E FONDIT LIMIT: 2,916,600 Lekë (dymilion e nëntëqind e gjashtëmbëdhjetëmijë e gjashtëqind), pa TVSH. nga buxheti i bashkisë Peqin për nevoja të bashkisë Peqin, për vitin 2024;

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Peqin ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3, ne masen 2% të vlerës së përlogaritur të kontratës ne një nga format e parashikuara ne ligjin nr.162/2020 date 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” konform nenit 83, perkatesisht ne vleren prej 167,400 (njëqind e gjashtedhjetë e shtatëmijë e katërqind) lekë ;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në objektin e aktivitetit të tij tregtar, (QKB) **“Riparim dhe mirembajtje të automjeteve”**, në përputhje me legjislacionin, në fuqi.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitin financiar 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më pak se 40% e vlerës së fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra 40% e vlerës së fondit limit, në të paktën 1(një) vit të periudhës së kërkuar të viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Vlera e xhiros se përcaktuar dhe te kerkuar nga autoriteti kontraktor kerkohet për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike te operatorit ekonomik si dhe per të vendosur kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. *(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës*

2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të bilanceve të vitit 2023 të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht: Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ne legjislacioni tatimor ku xhiroja dhe bilancet kane si afat perfundimtar per tu mbyllur dhe dorezuar prane organeve tatimore maksimumi deri ne fund te muajit Prill te vitit qe vjen. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë bazuar sipas ligjit nr.8438 date 28.12.1998 i ndryshuar. Shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

3 Operatori ekonomik duhet të ketë paguar taksat dhe tarifatat vendore për vitin 2024 (këstet e maturuara) për çdo vend të ushtrimit të aktivitetit (sipas QKB), sipas afateve të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë vërtetim për taksat dhe tarifatat vendore).

Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit. Dokumentacioni provues, i cili vërteton pagimin e taksave dhe tarifave vendore, do të dorëzohet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 76, pika 2 të LPP si dhe në ligjin Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c.

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 20% e vlerës së fondit limit. Këto shërbime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga institucioni shtetëror ose/dhe faturat tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e kryera.
- Kur shërbimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshminë përkatëse, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve per procedurën e hapur të thjeshtuar është përcaktuar se vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kësaj kontrate duhet të disponojë një staf punonjësish prej minimalisht 4 (katër) persona. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit; Konkretisht për këto pike operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar mesatarisht 4 (katër) punonjës për periudhën Dhjetor 2023-Janar-Shkurt-Mars 2024 të vertetuar me:

a. Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj për periudhën Dhjetor 2023-Janar-Shkurt-Mars 2024;

Ne lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit deshmues për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, mbajme në konsideratë përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM 285, DT.19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet që “Perpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorezimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjar “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j”, të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqeruese të ofertes, të dorezuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në original ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Argumentim: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 5/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Numri i kërkuar i punonjësve është përllogaritur si më poshtë:

Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik të ketë minimumin prej **4 (katër) punonjës** në stafin e tij, për të përmbushur me sukses kontratën.

1. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë **personelin teknik të nevojshëm për realizimin e kontratës**, në përbërje të të cilit të ketë **minimalisht 1 (një) punonjës të pajisur me dëshmi aftësie profesionale për veprimtari autoriparimi, në zbatim të nenit 4 dhe të pikës 2 të nenit 9 të ligjit Nr. 9573, datë 3.7.2006.**

Për të vertetuar se operatori ekonomik ka të punësuar në stafin e tij teknik personelin teknik të me profilet e punës të cituara më sipër, për secilin prej tyre duhet të paraqesë:

- kontratat individuale të punës.
- Operatori ekonomik të paraqesë deklaratë në lidhje me stafin që disponon sipas formatit të mëposhtem:

Nr	Emër Mbiemër	Profesioni	Data e fillimit të marrëdhënieve të punës
1			
2			

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do të paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 2.1:

Me qëllim garantimin e gjithëpërfshirjes, për t'i dhënë mundësi cdo operatori ekonomik për të marrë pjesë në procedurën përkatëse të prokurimit, punonjësit e mësipërm jo domosdoshmërisht duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë. Punonjësit mund të kontraktohen nga operatori ekonomik enkas për këtë procedurë prokurimi.

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kontratat individuale të punës të çdo punonjësi pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar.

Stafi që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

2. Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon të paktën **1 (një) ambjent, ku ushtron veprimtarinë, për kryerjen e shërbimit të riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve.**

Per sa me sipër operatori ekonomik të paraqes një deklaratë perkatese sipas formatit të mëposhtem:

Nr.	Vendodhja	Statusi
1		Pronesi/qira/perdorim/legalizim

Vendodhja që do të deklarohet detyrimisht do ti paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 4.1:

Nëse servisi, që disponon operatori ekonomik, ndodhet jashtë territorit administrativ të bashkisë Peqin, ku ndodhet autoriteti kontraktor, operatori ekonomik duhet të marrë përsipër, nëpërmjet një vetdeklarate, se do të kryerjë, me shpenzimet e veta, transportin e mjeteve, nga vendndodhja e autoritetit kontraktor deri në servis dhe anasjelltas, për të gjitha shërbimet e kërkuara në shtojcën 6.

Shënim 4.2:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore Operatorët ekonomikë për ambjentin që ushtron aktivitetin duhet të paraqesin pranë AK jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion që vërtetojnë pronësinë, ose qiramarrjen, ose huapërdorjen (certifikatë pronësie/ kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

5. Operatori ekonomik duhet të disponojë pajisje dhe instrumente minimale të nevojshme për zbatimin e kontratës, si vijon:

- a) pajisje për kontrollin dhe realizimin e gjeometrisë (konvergjences) së rrotave të mjetit, të paktën 1(një) copë;
- b) pajisje bango provë, për motorino dhe alternator (dinamo);
- c) pajisje diagnostikuese, të difekteve elektronike në mjete, të paktën 1 (një) copë;
- ç) pajisje urë ngritese për automjetet, të paktën 1 (një) urë për mjetet, objekt prokurimi.
- d) pajisje urë (grope) për mjetet e rënda.

Pajisjet që do të deklarohen, detyrimisht do t'i paraqitet Autoritetit Kontraktor për të qenë pjesë e planit të zbatimit të kontratës.

Shënim 5.1:

Në zbatim të ndryshimeve të reja ligjore operatorët ekonomikë duhet të paraqesin pranë AK, jo më vonë se 5 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit përfundimtar, dokumentacion për pajisjet dhe instrumentet e mësipërme, që vërtetojnë se, këto pajisje dhe instrumente i ka në pronësi, ose me qera, ose me huapërdorje (fatura blerje / dokumente zhdoganimit / kontrata qiraje / kontrata huapërdorje / kontratë dhurimi / çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë ose përdorimit sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë).

- e) Operatori ekonomik duhet të deklaroj Agregatet / Pajisjet / Pjesët e këmbimit duhet të ofrohen të reja dhe sipas afateve të garancisë të dhëna nga prodhuesi ose nga distributorë të autorizuar nga prodhuesi.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Njësia e Prokurimit